

ENGJËLLUSHE KARAJ

RRETH BOTIMIT TË FJALORIT SHPJEGUES TË A. XHUVANIT

Aleksandër Xhuvani (1880-1961) është një nga figurat të shquara të shkencave albanologjike. Ai, ndër të tjera, punoi tërë jetën me pasion e vizion, me dashuri e ngulm për studimin e lëvrimin e gjuhës shqipe. Për personalitetin e tij në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* shkruhet se “shtjelloi një veprimtari sistematike, të shumanshme, të gjerë e të frytshme si lëvrues e studiues i gjuhës shqipe. Puna e tij shkencore u karakterizua nga një vështrim i qartë e objektiv i çështjeve, nga një njohje e gjerë e gjuhës shqipe. Puna e tij shkencore u karakterizua nga një vështrim i qartë e objektiv i çështjeve, nga një njohje e gjerë e gjuhës shqipe, e strukturës gramatikore dhe e visarit leksikor të saj, nga lufta këmbëngulëse për një gjuhë shqipe sa më të pastër, të pasur e të paqortueshme, për të ngritur gjithnjë e më lart përpunimin e gjuhës letrare. Luftoi e punoi vijimisht për njësimin e gjuhës letrare të folur e të shkruar, për një gjuhë letrare të përbashkët për gjithë popullin shqiptar. Drejtoi hartimin e udhëzuesve të njëpasnjëshëm drejtshkrimorë (1949, 1951, 1951, 1954, 1956) që zgjeruan gjithnjë e më shumë rrethin e çështjeve që çelën rrugën për njësimin e plotë të drejtshkrimeve të shqipes më vonë.”¹

Aleksandër Xhuvani qe një nga njohësit më të mirë të visarit leksikor të gjuhës shqipe. Ai gjatë shumë vjetëve mblodhi me zell e dashuri fjalë e shprehje frazeologjike shqipe kryesisht nga goja e popullit, por edhe nga vepra të shkruara. Ai, si shumë të tjerë bashkëkohës të tij, si Nikolla Gazulli, Pano Tase, Lef Nosi, Mustafa Kruja, Tahir Dizdari e të tjerë kërkonte të hartonte një fjalor të shqipes. Ai, si rrallëkush tjetër, mblodhi pasuri leksikore e semantike që s’figuronin në fjalorët e shqipes. Ai ka meritë se njësitë mbledhura apo të vjela i ka regjistruar me jetën e tyre, me përdorime në thënie e fjali, duke mundësuar të fitohet një ide e qartë për shtrirjen e sferën e qarkullimit të tyre.

A. Xhuvani mblodhi fjalë gjithandej Shqipërisë. Shpesh regjistron me vetëdije, se dialektet e shqipes janë shumë afër njëri - tjetrit dhe pasuria leksikore e secilit është pasuri e gjithë gjuhës amtare. Mjafton një shembull për ilustrim ku folja *běj* jepet në formën **běj** / **bâj**:

běj / **bâj** fk., fjk.: 1) bër bani i bletës nuk bân mjaltë (Fjth. Ri); *shiu bën rrëketë e përrenjtë dhe lumenjtë* (N. Frash., Gjithësia, 70); *zjarri, stufa bân tym*: qit, nxjerr tym; **baj** keq; kryej një veprim të keq, **baj** mirë, **baj** liksht; **běj** / **bâj** punë; **bâj** pëlhurë, **bâj** këpucë; **bâj** dasmë; **bâj** krushqi; **bâj** bukë; **bâ** për asgjë; ndërtoj: **bâj** një shtëpi, një urë; **baj** një kopësh: krijoj; **bâj** çorape: thur

¹ *Fjalori Enciklopedik shqiptar*, Tiranë, 1985, f. 1189-1190.

çorape; **bâj** *nji palë rrobe; me të folë e me të barë* (me të bërë) (Shpati i Elbasanit); *të kërcyer që bâte* ai: kërcente bukur; *të qeshur që kemi bërë*: kemi qeshur shumë; *të qarë që ka bërë*: të qamë që ka qa: ka qarë shumë; **bunë** *darsmë*: bënë dasmë (shqip. e Ukrainës); 2) *veproj: mirë bërë; e bane mirë që i the ashtu*, krhs. gr. καλῶ ἔκανε; *mirë ja bane; i ati bëri si bëri dhe e dërgoi të studiojë*, thuhet për diçka që realizohet me përpjekje të mëdha; *se ç'mirë m'ia bâte* *ati ujkut që na ha dhentë*; 3) *lind (fëmijë, gocë, çun): kjo grue ka bâ* *shume fëmijë; ajo bani çun; macja bani këlysh; pula bani ve*; prodhon: *arra s'bani* *gja simjet*; 4) *më ban mirë, më ban keq*: ka efekt të mirë, të keq për shëndetin tim, gr. μεώφεται, δέν με ώφεται; **běj** *ballë*; duket (së largu), shfaqet; **bani** *ballë karvani* (edhe: dha ballë), fr. *poindre*, it. *fracapolino*; edhe: **bani** *beli* (kjo fjalë e fundit turq.); (i) **běj** *ballë*: i qëndroj; **běj** *rrugë*: udhëtoj; **běj** *gjumë*: flej; **běj** *pushkë*: qis pushkë, luftoj; **bâj** *kuvend*; *ç'bane me te?* *s'kam se, ç't'i bâj*: gjerm. *ich kann ihm nicht helfen*, rum. *nu pot să-i fac nimic; më vjen keq prej tij, por s'kam ç't'i bâj*: rum. *nâ i milâ dë dînsâ, dar n'am ce – i fac; s'kam të běj me të*: s'kam lidhje me të; 6) *e bânj në të keq atë*: e konsiderojnë, thonë se është i keq; *ndonëse më vrau djalin, ... unë nuk ia bënj për mëri* (Donzon, 56); 7) *më ban pak vend*: lëviz ca, që të më lësh vend edhe mua, it. *farmi sedere*; 8) *i bâj vollet, koret* (një fëmijë): ia përmbush dëshirat, qejfin; sh. edhe FGJSH 617 voll-i: *...mos ia běj* *vollin*: mos ia bëj qejfin; 9) *ai bani ca ditë që nuk e hante ma qumështin*: nuk e ha qumështin prej disa ditësh, ka disa ditë që nuk e ha më qumështin; 10) *dy e dy bânj në katër; emrat mashkullorë e bëjnë shumësin më -a dhe -e; sa ban llogaria?*; 11) **bâj** *ment të ...*: vendos, kam qëllim të ...; (i) **bâj** *zâ*: (i) thërres; **běj** *pallë*: prehem, pa e çarë kokën për asgjë; **bâj** *vapë*; **běj** *gjumë*: fle; **ban** *dorë*; **bani** *kambë* (diçka): u zhduk, dikush e mori, e vodhi; **bente** *be e rrufe* (edhe: bera e rrufera): betohëj me të madhe; *mos bëjnë bee rerë* (Matrënga, 38): *mos bëjnë be të rremë*, mos betohen me të rremë; i bëj bisht: i largohem (një njeriu a pune); i bëj dredha; **bâj** *buzë në bukë, në të ngrënë*, fr. *bouder à la table*; *i bâ* *buzë* (nji gjâje): nuk e pëlqej, dua një më mirë: *i běj* *buzë gjizës* (se më pëlqen më shumë djathi), *i běj* *buzë një pëlhurë prej leshi*: nuk e dua, se më pëlqen më shumë një prej mëndafshi; sh. edhe: i vari, i lëshoi buzët, rri me buzë varë a me buzë lëshuar (kur nuk më pëlqen një gjë dhe rri i zemëruar), po ashtu: *i bie* *buzës dikujt*: e kundërshtoj; e qorto, kur nuk e pëlqej një fjalë që thotë tjetri: *pse nuk i bie* *buzës ajo, kur flet edhe për të vëllanë?*; 12) *ia běj me dorë*: i tregoj me dorë, i jap shenjë me dorë, e thërres; *ia běj me sy*: i luaj syrin; **běj** *me krye*: lëviz kryet; *i bâj* *fjalë* (ndonjë gjëje), p.sh. një libri, një petku, ndonjë monedhe, pse është e vjetër, e grisur: nuk e qas, nuk e pranoj; **běj** *fjalë me* (ndonjë): zihem me ...; b) mirrem vesh me..., **bie** *në ujudi me ...*, it. *intendersi*, gr. *συνενπρούμαι*; **běj** *për vehte* (dikënd); 13) *i bâmë* *paret dru sot*: i shpenzuam gjithë paret e blemë dru; 14) *lyej, përlyej: e běj me baltë, me vaj: i bâna duert me të nxime; e běj me turp*: e turpëroj; *e běj me vajë*: i shkaktoj vajë, bëhem shkak që të

qajë; *s'ja bāni befrin e u vra*: nuk u ruejt, nuk mori masa; 15) **běj** që...: bëhem shkak që... (i jep kuptim figurativ foljes së mëpasme): *mos e bān të qeshi*; *do të më bajsh që të mos flas më*; *mos më bān që të të bërtas*, gjerm. *jemandem veranlassen dass...*; *nuk erdhe të shuesh dritën e më bane* (shtrëngove) *që të ngrihem e ta shuej vetë*; **bani** (urdhëroi) *me e ndalë karrocën*; 16) fitoj, nxjerr: **běj** *bukën e gojës*: me punën e tij fiton sa të ushqehet; 17) *ai kishte bā një muej burg*: kishte ndejtur një muaj në burg, e kishte mbushur një muaj; 18) *ku do ta bājsh* (një festë): *ku do ta kalosh*, it. *passare* (una festa); 19) *më kan bā sytë*, veshët: *më kanë gënjyer*, më është dukur sikur pashë, sikur dëgjova diçka: *po qan ajo apo më bājn veshët mue?*

fjk. 20) **bāj** si...: imitoj: **běj** *si macë, si qen, si zog* etj.: gërthas si mace etj.; **bān** *si i sëmurdë*: shtiret si i sëmurdë; **bā** *si i mallkuem*; 21) shkoj: *ai bëri pak më tutje*; *nuk bënë më tej*, **běj** *tej*: shkoj tutje: **bëri** *tej*; *ia mori dhe bëri tutje*; **djali bāni** (zbriti) *shkallët teposhtë ngutshëm*; *dukej sikur bënte poshtë*; **běj** *përpara*; *nuk e pamë se nga bëri* (Pedersen, Tekste 87): *nuk e pamë se nga vajti*; **bān** *nga bān*, *eja këtu pastaj*; *duhet të pritinin çetën që s'kish pak e pat bërë poshtë* (J. Xoxa); - *Ju lumtë!* - *thirri një nga partizanët duke bërë në këmbë*: ...duke u ngritur më këmbë; 22) për kohën: *dje bāni mot i mirë, sot po bān një mot i lig*; *kur bān moti i lig...*; **bānte** *nji të ftohtë i madh*; 23) *s'më bëjnë duart*, *s'më bëjnë këmbët*: *s'më punojnë*, i vë në lëvizje me vështirësi; *nuk i bënin duart të shtronte e të ngrinte shtratin nga hidhërimi* (ishte në një gjendje shpirtërore që e paralizonte); *u ngrit të ecte, po s'i bënte këmba* (nga dhimbja, nga plaga, nga lodhja); *nuk më bën zemra të...*: nuk jam i disponuar shpirtërisht për diçka, s'kam guxim të...; *si ju bën zemra të thonë ashtu?*: si ju thotë ndërgjegjja...!; 24) tregon mundësi e pamundësi; *nuk bëj dot pa të*, fr. *je ne peux me passer de lui*; shënon diçka që folësi mendon, ka frikë se mos ndodhë: *jo s'due m'e pa, se bān e ma vret syni mecin*; 25) *nuk bān kjo*: nuk vlen; *sa bān kjo?*: sa vlen, sa kushton kjo?; *nuk bājnë këta ftonj*: s'janë të mirë; *mos i bli ata rrush se nuk bāhen*; *ai vend nuk bān* (nuk është i mirë, nuk vlen) *për kullotë*; *ky kalem nuk më bān për prodhime*; *nuk më bëjnë këto këpucë*: nuk më vijnë për këmbë; *kjo ngjyrë nuk bān për burra*: nuk ka hije, nuk shkon për burra, gjerm. *passen, sich schuchen*: *kjo* (rrobe, punë etj.) **bān** (nuk bān) *për tyj*: s'të ka hije, s'vlen për ty; *nuk bëj për këtë punë*: nuk vlej, s'jam i përshtatshëm; 26) nuk ka hije, nuk është mirë: *nuk bān të rrijshtë këtu, të flasësh kështu* etj. ose *nuk bān më ndejë këtu, me folë kështu*: s'është mirë, është turp; *nuk bān t'i shkruesh ti atij*: nuk duhet, nuk të ka hije ty: *nuk bān të vemë sot atje*: nuk shkon; *nuk bān t'ia thuesh atë fjalë*: nuk ecën, nuk ka hije: *nuk bānte që të mos shkojshe*; 27) nis (tregon fillim të një veprimi): *kështu iu përgjegj mësonjësi dhe bëri të dalë*; *sa bëri të shkruante* (sa filloi të shkruante) *hyri në dhomë drejtori*; *běj përpjekje, po pa rezultat: ajo si e dëgjoi, bëri të ngrihej, po nuk mundi; bāna që ta ndez dritën, nuk u ndez; bāj ta za e nuk e zā dot; bëj të nisem po s'di nga t'ia mbaj; tek bëri që të dilte dervishi, e*

zunë djemtë; kur bëri që ta zbulonte, ai ulëriti si qen; i ati bëri si bëri dhe e dërgoi të studiojë: me përpjekje të mëdha arriti ta dërgojë...; 28) Xha Miti bënte e numëronte djathtas e mëngjërës konakët e djegur.

Me të drejtë FESH pohon se fjalori që do të hartonte A. Xhuvani, me lëndën e mbledhur dhe të skeduar, “do të ishte një kontribut i rëndësishëm me vlerë të veçantë në fjalorin e përgjithshëm të shqipësisë, në studimet leksikologjike, e gjuhësore në përgjithësi. Po ai s’pati kohë të shkojë përtej fazës regjistruese të parë të materialeve, pa arritur të bëjë përpunimin e tyre, as edhe verifikimet e plotësimet e nevojshme, as sistemimin.”² Materiali i pasur leksikor e frazeologjik që la prof. dr. A. Xhuvani, i përbërë prej 30000 skedash, nga të cilat mund të dalë një vepër leksikografike prej rreth 13-14000 fjalësh të një vëllimi prej më se 1000 faqe të daktilografuara, u sistemua dhe u përpunua në formë fjalori nga Mahir Domi e Qemal Haxhihasani dhe qysh nga viti 1971 janë botuar në revistën “Studime filologjike”.³

Por procesi i sistemimit dhe i përpunimit ka shpesh mangësi që nuk prekin përmbytjen, por që dëmtojnë veprën dhe që ndonjëra prej tyre lidhet edhe me kushtëzimet që buronin nga koha dhe ideologjia komuniste. Kështu, A. Xhuvani, një pjesë të madhe të shembujve e ka vjelë nga autorët e vjetër të cilët, por në lëndën e botuar vihet re që shembujt që lidhen me botën fetare, shpesh janë mënjeluar ose tjetërsuar. Fjala [Krishti] është zëvendësuar me [...]

afroj fjk.: ora **afroi**; // **afrohem, afronem** fm. i **afrohem** (dikujt a diçkaje) dhe **afrohem** te anë: **u afëruen** te fshati i tyre (Mitko, “Bleta”, bot. i Pekmezit 304); **afrohem** tek ndonjë; **afronetë** në të ndarë të bukurisë dheut (Doz. 24), e **Krishti** i **afrohet** prej sojet (P. Babi, 193): i **afrohet** asaj; sh. edhe FGJSH.

Gjithashtu ka tek-tuk gabime që lidhen me përkthimet në gjuhë të huaj. Mbetet për t’u parë nëse këto gabime janë thjesht tipologjike. Në frëngjisht trajta përfaqësuese e foljes është infinitivi (l’infinitif: **se démener, s’agiter**). Në rastin e mëposhtëm janë dhënë në vetën e tretë njëjës pa përemrin vector, pa një kryefjalë: **mpshonj, mpshoj** fjk., 1. anoj: *selvija zuri të mpshojë tatëpjetë; as nukë mpshon mbë një anë* (Bogd. 54): it. *inclina a una parte*; 2. rëndo: *mkatetë tonë mpshonjë në mbi nee si maletë e sukëtë mbi këte dhe* (Pj. Budi, Pasq. 232); *drue se ... e keqeja e tyne mbë nee ka me mpshuom* (ib. 237); 3. *zemra mpshon*: gjerm. *das Herz lobt*; fr. *se démene, s’agite vivement*; **mpshonj** më ndonjë: ankohe, qahem kundër dikujt për ndonjë gjë që

² *Fjalori Enciklopedik shqiptar*, Tiranë, 1985, f. 1189-1190.

³ Po listojmë këtu numrat e revistave ku janë është botuar ky fjalor: 1971/ 1; 1972/1, 2, 3, 4; 1973/3, 4; 1974/ 1, 2, 3; 1975/1, 2, 3, 4; 1976/ 1, 2, 3; 1977/2, 3, 4; 1978/1, 3, 4; 1979/1, 2; 1980/1, 4; 1981/ 1, 2, 4; 1982/ 1, 3, 4; 1983/1, 2, 3, 4; 1984/1; 1985/3; 1986/1, 2; 1987/1, 2, 3, 4; 1988/1, 2, 3; 1989/1, 2, 3; 1990/ 1, 2.

s'është e mirë; *mos mps*ho për të këqiat (N. Frash.): mos u qaj, mos u anko për të këqiat; **mpshtonj**: gulçoj gr. γρούζω, it. *mormorare*, *lagnarsi* (Leake): Shih edhe FGJSH 312 **mëshoj**, f. 325 **mshoj**.

Një tjetër problem që vërehet në materialin e botuar, është dhe shkrimi i emrave të vendeve apo të autorëve ku janë vjelë, duke u gjendur para luhatjeve në gjithë fjalorin. p.sh. Një herë shkruhet (Pj. Budi) e tjetër herë (Budi), një herë (Gjirok), e herë tjetër (Gjir.) etj.

bridhm/ë-a ef. brithm/ë-a ef. të bredhurit (Pj. Budi); këcim në valle: *në qishdo lodërti e bridhmë* (Pj. Budi, Pasq. 196); nga bredh: luaj valle (Budi, Pasq. 45).

brenim-i em. 1. shi i madh, shi i shumtë, i ngadalshëm, i vijuar, që mba shumë (Gjirok): *sot qe një brenim*; shi i madh me vrull; 2. të ftohët i thatë me erë (Gjir.).

Ne kemi marrë përsipër ta botojmë fjalorin të plotë. Dhe puna filloi me nxjerrjen e pasurisë që gjendet te “Studimet filologjike”. Pasi e studiuam materialin, vendosëm të punonim mbi disa kritere që së shumti lidhen me teknikat leksikografike, dhe që mbështeten edhe në traditën e krijuar në botimet e gjuhësisë sonë në këtë fushë, por edhe ato bashkëkohore në gjuhësinë botërore. Disa nga këto kritere, të miratuara edhe nga leksikografi Valter Memisha, po i japim më vazhdim:

- Do të vendosen theksat në fjalët-titull.

- Do të riorganizohen treguesit morfologjik, sidomos, duke i vendosur atje ku mungojnë, si - *m.* (gj. mashkullore), *f.* (gj. femërore), *as.* (gj. asnjënjësore), *sh.* (n. shumës) etj.

- Nuk do të ketë në thënie të ndryshme reduktime fjalësh, që zëvendësohen nga një *vijë* dhe pastaj jepet treguesi gramatikor p.sh. **babaraq/e-ja f.** *Të ftohtët i shtiu* – **n.** Fjala do të jepet e plotë: *i shtiu babaraqen*.

- Do të vendoset vija e pjerrtë (/) për kufirin morfematik të temës: **babaraq/e-ja**.

- Do të fillohet me shkronjë të madhe pas çdo kuptimi.

- Variantet fonetike do të futen te fjala titull, p.sh. *babaraq/e-ja* (*babëraq/e-ja*, *beberaq/e-ja*).

- Nuk do të përdoret shenja e barazimit (=), kur kemi njësi frazeologjike, por njësia frazeologjike do të jetë me shkronja të pjerrëta (*italike*), kurse shpjegimi me shkrim normal.

- Shpjegimet do të korrigjohen dhe do të sillen në gjuhën e njësuar.

- Nuk do të ketë sinonime në kllapa brenda një vargu si p.sh. *babaraq/e-ja* 2. *pikë*, *drithtim* (*panik*), por ato do të jepen të ndara me presje ose pikëpresje (e kushtëzuar nga funksioni semantik).

- Nuk do të ketë shpjegime të panevojshme në kllapa: babanaq/e-ja – bukë misri e papjekur mirë (e pakulluar mirë), por – bukë misri e papjekur mirë, e pakulluar mirë.

- Kur jepen shembuj, thënie ilustruese nuk do të jepen me sinonime si barazvlerës të fjalës a të kuptimit të përdorur: *babëzi-a 2. prapësi, varfëri. Gjumi i shumtë është = varfër*. Por *Gjumi i shumtë është babëzi*.

- Nuk do të ketë pikëpresje (;) pas fjalës titull, por pikë (.) nëse nuk ka elemente plotësuese; nëse ka elemente të tilla, nuk do të ketë shenjë pikësimi (.) para këtyre elementeve, por në fund.

- Në se për një fjalë do të ketë përdorim dysh, emëror dhe mbiemëror, do të kemi përdorimin e elementeve plotësuese *em., edhe si mb. ose mb. edhe si em.*

- Do të riorganizohen edhe shkurtimet e tjera, të cilat do të jenë: *kal.* (folje kalimtare), *jokal.* (folje jokalmimtare), *vetv.* (folje vetvetore), *pj.* (pjesëz), *ndajf.* (ndajfolje), *euf.* (eufemizëm) etj.

- Kur ka sinonime fjalëformuese, si *baliqe, baliskë, baloshe, balushë*, fjalët do të jepen si leksema të veçanta nëse ka ndryshime të mëdha fonemore.

- Variantet fonetike (theksore) do të jepen: njëra fjalë titull, tjetra në kllapa, bala. P.sh. *báh/e-ja* (bahé-ja) f. ...

- Foljet vetvetore a mesore do të dalin si fjalë tituj. P.sh. *dergj* dhe *dergjem* do të jenë dy njësi të veçanta.

- Mbiemrat e nyjshëm do ta kenë të prapavendosur nyjën afërt (i, e) ose afërm (i), -e (e).

- I gjithë fjalori do të pajiset me shënimet përkatëse gramatikore të cilat thuajse mungojnë në skedina.

Po japim për ilustrim fjalën *ditë*, si është dhënë në faqet e revistës dhe si do të jetë në botimin e ardhshëm në formatin e një fjalori të veçantë:

ditë-a ef; shm. **dit-ët**: *sot kam –n për ke doktori* = afatin; në **-t tona** = në kohën tonë (shumësi **ditë** - me kuptimin kohë); në **-t të akëcilit**, gjerm. *zur Zeit von; jam a ndodhem në – të keqe; e tek vuante ajo mb'atë – mbyllturë nënë dhe* (Bleta, zi, 276, 297); *arrimë në një – të zezë; mbetem në – të keqe; vështroni se në ç' – e sollli veten = në ç'gjëndje; kur e pa vehten n'atë –; vuajtjet e kanë prurë në këtë – = gr. εἰς αἴμα τὸν χυτασ, ταμ; ka ardhur në – të pikës: gr. χαυῖν ηαυως; janë në – të hallit; ka ardhur në – të keqe; e tek vuante ajo mb'atë – (M.P. 297); asqeri i ngratë thyerë e prishurë mbë – të keqe (ibid. 282); po të shëkoni se kordha zu të pikonjë gjak, të delni të me kërkoni se do të ndodhem mbë – të keqe (ibid. 276); ja gjeta **-n** (kohën për keq); gjeta **ditën** (gjeta kohën e duhur për t'i bërë ndonjerit dishka të mirë); do të ja gjej **-n; -a që vjen ma mirë bahet; -a që vjen po bahet me keq; -a që asht –; rritet – e për –; gjithë -n e -s; kur të piqen dy – bashkë** (punë e pamundur); *kthen -a* = gr. ζυμερώνει (L. 336); u thye **-a** = gjerm. *der Tag**

geht zu Ende; e di si – nusje; iu baftë –a një mijë; t'u rittë –a t'u baftë një mijë; dritt e glata (për ngushëllim = vetë shëndoshë) (Arb. e It.).

dit/ë,-a *ef. shm. dit-ët: sot kam ditën për ke doktori: afatin; në ditët tona: në kohën tonë (shumësi ditë - me kuptimin kohë); në ditët të akëcilit, gjerm. zur Zeit von; jam a ndodhem në ditë të keqe; e tek vuante ajo mb'atë ditë mbyllturë nënë dhe* (Bleta, zi, 276, 297); *arrimë në një ditë të zezë; mbetem në ditë të keqe; vështroni se në ç'ditë e sollli vehten: në ç'gjëndje; kur e pa vehten n'atë ditë; vuajtjet e kanë prurë në këtë ditë: gr. εἰς αἴμα τῶν χαλασ, ταμ; ka ardhur në ditë të pikës: gr. χαρήν ηαωος; janë në ditë të hallit; ka ardhur në ditë të keqe; e tek vuante ajo mb'atë ditë* (M.P. 297); *asqeri i ngratë thyerë e prishurë mbë ditë të keqe* (ibid. 282); *po të shëkoni se kordha zu të pikonjë gjak, të delni të me kërkoni se do të ndodhem mbë ditë të keqe* (ibid. 276); *ja gjeta ditën* (kohën për keq); *gjeta ditën* (gjeta kohën e duhur për t'i bërë ndonjerit dishka të mirë); *do të ja gjej ditën; dita që vjen ma mirë bahet; dita që vjen po bahet me keq; dita që asht ditë; rritet ditë e për ditë; gjithë ditën e ditës; kur të piqen dy ditë bashkë* (punë e pamundur); *kthen dita: gr. ζυμepóveτ (L. 336); u thye dita: gjerm. der Tag geht zu Ende; e di si ditë nusje; iu baftë dita një mijë; t'u rittë dita t'u baftë një mijë; dritt e glata* (për ngushëllim: vetë shëndoshë) (Arb. e It.).

Duke përfunduar theksojmë se botimi i fjalorit ka qenë një detyrë e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, por që mu ngarkua mua. Është një barrë e rëndë, por më nderon. Fjalori do të jetë jo thjesht një vepër me autor prof. A. Xhuvanin, por ai do të jetë shumë i rëndësishëm në punën me fjalën shqipe dhe për fjalën shqipe. Ai do të jetë libër pune për studiuesin, për gazetarin, për studentin, për gjithë dashamirët e gjuhës dhe të kulturës sonë.

